REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
K R Y E T A R I

Nr. 2886 Prot., Maliq, më 27.05.2026

PROJEKT-VENDIM -NR. 6

"Për dhënie ndihme financiare të menjëhershme familjeve në nevojë"

Bazuar në ligjin nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore"* neni 29, ligjin nr. 45/2019 *"Për Mbrojtjen Civile"*, neni 30, gërma '**gj**' dhe neni 41, pika '**2**' , VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore si dhe fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore",* Kreu III pika 1-Procedura e vlerësimit të dëmeve germa *"a"* dhe *"ë"*, për rastin e rënies së zjarrit në banesën e z. S[redacted] K[redacted], banues në fshatin Vloçisht- njësia Administrative Libonik, bashkia Maliq:

i kërkoj Këshillit të Bashkisë Maliq;

1.Të miratojë një ndihmë financiare prej 1.102.000 lekë, për familjen e z.Stradimir Kreka, të cilit i'u dogj banesa më datën 16.05.2026 - ku vlera e plotë e dëmit të shkaktuar në banesë nga ana ndërtimore është 1,*648,035.32* lekë (*50% e vlerës e barabartë me **824.017.66** lekë*). Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake është *278.000* lekë.

- Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **1,102,017.66** lekë.

2. Pagesa do të bëhet nga Programi i Mbrojtjes Civile simë poshtë:

Gr.	Kap.	Kod.Prog.	Llog.Eko.	Vlera (000)
17	01	10910	604	1.102

3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi mbas miratimit të bazueshmërisë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut, Korçë.

KRYETARI I BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE KRIZAVE

2886

Maliq, më datë 27.05.2026

Relacion

Për përcaktimin e masës së ndihmës financiare të menjëhershme për familjen e z. S[redacted]a të cilit i është djegur banesa nje-katëshe, si pasojë e zjarrit.

Në datën 16.05.2026, ora 02:29 u dogj banesa nje-katëshe e z. S[redacted], banues në fshatin Vloçisht, Njësia Administrative Libonik dhe si pasojë pati dëme nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Bazuar në VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësitë natyrore ose veprimtaria njerëzore*", sipas përcaktimit në Kreun III, pika1, gërma *"b"*, Komisioni i Konstatimit të Gjendjes bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.308, datë 21.05.2026, shkoi në banesë dhe përgatiti procesverbalin e konstatimit të gjendjes. Bazuar në procesverbalin e mbajtur u hartuan edhe preventivat për dëmet e shkaktuara nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Në bazë të preventivave dëmi në anën ndërtimore është në shumën 1,*648,035.32* lekë (*50% e vlerës e barabartë me* ***824.017.66*** *lekë*).Vlera e dëmit në orendi elektroshtëpiake është *278.000* lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **1,102,017. 66** lekë. Mbështetur në preventivat sa më sipër i propozohet Këshillit të Bashkisë për dhënien e ndihmës financiare si më poshtë:

Ti jepet një ndihmë financiare z. S[redacted] për dëmet nga ana ndërtimore në një shumë prej ***824.017.66*** lekë, pajisje dhe orendi elektroshtëpiake në një shumë prej *278.000* lekë. Totali për t'u dëmshpërblyer është **1,102,017. 66** lekë.

- Propozimi i mësipërm është bërë duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore"neni 29, ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", neni 30 dhe 41 dhe VKM-në nr.329, datë 16.05.2012;*
- Vendimit nr. 148, datë 24.12.2025 *"Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2026".*
-

	Emër /Mbiemër	Nënshkrimi	Data
Konceptoi:	R. Mara		27.05.2026
	Ll. Kotmillshi		27.05.2026
Përgjegjës Sektori:	S. Belishta		27.05.2026

KRYETARI I BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Maliq, më datë 27.05.2026

2886

Relacion

Për përcaktimin e masës së ndihmës financiare të menjëhershme për familjen e z. [redacted] të cilit i'u dëmtua banesa një-katëshe, si pasojë e rënies së zjarrit dhe pati dëme të konsiderueshme materiale - si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake.

Në datën 16.05.2026, ora 02:29 u dogj banesa e z. [redacted], banues në fshatin Vloçisht, Njësia Administrative Libonik dhe si pasojë pati dëme nga ana ndërtimore, si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Bazuar në VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësitë natyrore ose veprimtaria njerëzore*", sipas përcaktimit në Kreun III, pika 1, gërma *"b"* Komisioni i Konstatimit të Gjendjes bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.308 datë 20.05.2026 shkoi në banesë dhe përgatiti procesverbalin e konstatimit të gjendjes. Bazuar në procesverbalin e mbajtur u hartuan edhe preventivat për dëmet e shkaktuara nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake. Në bazë të preventivave dëmi në anën ndërtimore është në shumën 1,*648,035.32* lekë (*50% e vlerës e barabartë me **824.017.66** lekë*). Vlera e dëmit në orendi elektroshtëpiake është *278.000* lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **1,102,017. 66** lekë.Mbështetur në preventivat e mësipërme dhe aftësitë financiare të Autoritetit Vendor i kërkojmë Drejtorisë të Financës dhe Buxhetit të akordojë ndihmën financiare të menjëhershme për familjen e z. [redacted] i'u dogj banesa si pasojë e rënies së zjarrit dhe jeton në kushte të vështira ekonomike. Lidhur me situatën, mbulimi i dëmit të shkaktuar për familjen e [redacted] të bëhet nga fondi i Mbrojtjes Civile në Bashki në vlerën **1,102,017. 66** lekë.

- Propozimi i mësipërm është bërë duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", *neni 29,ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", neni 30 dhe 41 dhe VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012:*
- Vendimit nr. 148, datë 24.12.2025 "*Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2026*".
-

	Emër /Mbiemër	Nënshkrimi	Data
Konceptoi :	R. Mara		27.05.2026
Spec. Emergj. Civile	Ll.Kotmilloshi		27.05.2026
Përgjegjës Sektori :	S. Belishta		27.05.2026
Specialist i Sektori Juridik	R. Murataj		27.05.2026
Drejtore e Financës dhe Buxhetit :	A. Muka		27.05.2026

KRYETARI I BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026

Projektuesi: Ing.MARJANA ZHULI

Objekti: Rikostruksion banese e djegur .fshati Vloçisht .Z.Stradimir Kreka

Datë: 20-05-2026

PREVENTIV

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
		1. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI				
1	2.292	Trare tavani te sharruar >	m2	90.0	507.69	45,691.65
2	2.295	Tavan rrjete teli + suva >	m2	70.0	3,472.27	243,059.04
3	2.312	Suva brenda mur guri ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 >	m2	192.0	1,372.34	263,488.90
		Shuma 1:				**552,239.59**
		2. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE				
4	2.219	Çati vendi e zakonshme me HD~8m,tjegulla marseljeze >	m2	110.0	4,169.28	458,621.24
5	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm >	ml	38.0	1,316.77	50,037.07
6	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 >	ml	12.0	1,122.99	13,475.88
7	2.203	Veshje kornize llamarine xingat >	m2	5.0	2,185.24	10,926.18
		Shuma 2:				**533,060.37**
		3. PUNIME SHTRESASH 2				
8	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20 >	m3	4.0	13,543.20	54,172.79
9	2.279	Shtrese derrasa FM 2.5cm >	m2	28.0	2,587.24	72,442.69
		Shuma 3:				**126,615.48**
		4. PUNIME HEKUR BETONI				
10	2.166	F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm >	ton	0.3	136,025.04	40,807.51
		Shuma 4:				**40,807.51**
		5. PUNIME DYER DRITARE				
11	2.375/2a	Dritare d/alumini dyfi xh. >	m2	7.5	11,649.23	87,369.25

12	2.388/1	F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara >	m2	13.0	14,263.71	185,428.27
		Shuma 5:				**272,797.52**
		6. PUNIME BOJATISJE				
13	2.399	Sherbetisje e bojatisje me gelqere >	m2	192.0	100.15	19,228.22
		Shuma 6:				**19,228.22**
		7. INSTALIME PER NDRICIM				
14	2.490/b	F.V. Kasete plastike KE me 6 modular (vende) >	copë	1.0	1,429.39	1,429.39
15	2.487	F.V. Kutiderivacioni plastm >	copë	6.0	225.63	1,353.81
16	2.480/2	F.V. Tub plastmasi Ø 18-21mm >	ml	200.0	222.00	44,399.40
17	2.481/2	F.V. Percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2 >	ml	600.0	61.41	36,843.60
18	2.486	F.V. Portollampa norm 10 A >	copë	4.0	374.88	1,499.51
19	2.485/1	F.V. Çeles 1 polar 220V 10A >	copë	4.0	740.68	2,962.72
20	2.485/g	F.V. Priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A >	copë	6.0	865.86	5,195.14
21	2.490/1a	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A >	copë	2.0	1,418.79	2,837.58
22	2.490/1b	F.V. Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A >	copë	4.0	1,691.37	6,765.48
		Shuma 7:				**103,286.63**
Shuma Analiza						**1,648,035.32**
Fondi Rezervë (0.0%)						**0.00**
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (0.0%)						**1,648,035.32**
TVSH (20%)						**329,607.06**
Shuma me TVSH						**1,977,642.38**
Totali						**1,977,642.38**

Preventivuesi:

ING.MARJANA ZHULI

Investitori:

BASHKIA MALIQ

Shënime:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Maliq, më 25.05.2026

Preventiv

Preventivi i dëmit në orendi dhe pajisje të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e z. [redacted] banues në fshatin Vloçisht, Njësia Administrative Libonik, të cilit i'u dogj banesa më datën 16.05.2026

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi/Njësi (lekë)	Shuma
1	Divane	Copë	4	30.000	120.000
2	Sobe elektrike	Copë	1	25.000	25.000
3	Karrige të zakonshme	Copë	4	4000	16.000
4	Tavolinë Buke	Copë	1	18.000	18.000
5	Frigorifer	Copë	1	22.000	22.000
6	Televizor	Copë	1	22.000	22.000
7	Lavatriçe	Copë	1	25.000	25.000
8	Krevat dopio (dhomë gjumi)	Copë	1	30.000	30.000
Totali					**278,000**

Çmimet e orendive dhe pajisjeve i janë referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2016 dhe 2023.

Komisioni:

1-Ilirjan Islamaj

2-Marjana Zhuli

3-Rodjan Mara

KRYETARI BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr.____Prot. Maliq, më 22.05.2026

Procesverbal-Konstatimi

I mbajtur në datën 22.05.2026 në banesën e z. [redacted], banues në fshatinVloçisht, Nj. Administrative Libonik, në zbatim të Urdhërit të Kryetarit nr.3[illegible] datë 0[illegible].05.2026, komision i i konstatimit të gjendjes evidentoi se në banesë dy-katëshe ku jetonte familja e z. [redacted] pati dëme të konsiderueshme nga ana materiale si dhe në orendi dhe pajisje elektro-shtëpiake si më poshtë:

a-DËME NGA ANA NDËRTIMORE

1.Punime Çatie

2.Punime Suvatimi

3.Punime dyer /dritare

4.Punime Bojatisje

5.Punime elektrike

6. Punime shtresash

b-DËME NË ORENDI DHE PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE

- Sobë me korent, copë 1;
- Divane, copë 4;
- Karrige, cope 4;
-Tavolinë buke, cope 1;
- Frigorifer, cope 1;
- Televizor, cope 1;
- Lavtarice, cope 1;
- Krevat dopio (dhome gjumi), cope 1

Komisioni

1. Stiljan Belishta

*2.*Rudina Bregu

*3.*Llambi Kotmilloshi

KRYETARI BASHKISË

Gëzim TOPCIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr.3105 Prot

Maliq, më 21.5.2026

URDHËR

Nr. 308, Datë 21.5.2026

PËR
NGRITJEN E KOMISIONEVE TE KONSTATIMIT TË GJËNDJES DHE VLERËSIMIT TË DËMEVE NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E Z. STRADIMIR KREKA, NË FSHATIN VLOÇISHT, NJËSIA ADMINISTRATIVE "LIBONIK"

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*i ndryshuar, neni 64 "Kompetencat e Kryetarit të Bashkisë", gërma "a",Ligjit Nr. 45/2019*"Për mbrojtjen civile"*,neni 30, gërma"gj",VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqesitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", Kreu III, pika 1 "Procedura e vlerësimit të dëmeve" germa "b", për evidentimin e gjendjes së krijuar nga rënia e zjarrit në datën 16.05.2026, në banesën e Z. Stradimir Kreka, në Fshatin Vloçisht, Njësia Administrative Libonik,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Komisionit të Konstatimit të Gjëndjes dhe Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve për evidentimin e situatës nga rënia e zjarrit në shtëpinë e Z. [redacted], në Fshatin Vloçisht, Njësia Administrative Libonik, me përbërje si më poshtë:

Komisioni i Konstatimit	**Komisioni i Vlerësimit**
a) Stiljan Belishta	a) Ilirjan Islamaj
b) Llambi Kotmilloshi	b) Marjana Zhuli
c) Rudina Bregu	c) Rodjan Mara

2. Komisionet të hartojnë proces-verbalet e konstatimit të dëmeve dhe vlerësimit të dëmeve të shkaktuara, për tja bërë prezent Këshillit të Bashkisë.

3. Të njoftohet Sektori i Mbrojtjes Civile pranë Prefekturës së Qarkut Korçë.

4. Të plotësohet dosja përkatëse me gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ligji duke ndjekur hap pas hapi ecurinë e problemit.

5. Për zbatimin e ketij urdhëri ngarkohen komisionet e ngritura ne pikën 1 të ketij urdhëri.

6.Ky urdher hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ